



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i porcesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, mbajtur më 09.08.2022, me fillim në ora 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, Amir Simnica dhe Sami Boroci.

Munguan: Arianit Beqiri dhe Rozafa Fetahaj.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Arbër Sadiki dhe Mimoza Sylejmani.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Boroci, me këtë

R E N D D I T E :

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit;
2. Të ndryshme.

Pika e parë
Zgjedhja e kryesuesit.

Me propozim të Pëllumb Bajçinovcit, kryesues i Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit njëzëri u zgjodh Amir Simnica.

Pika e dytë
Të ndryshme

Anëtarët e Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, u pajtuan që të bëjnë një plan të punës, si dhe bashkëpunimin me drejtorët e drejtorive përkatëse.

Mimoza Sylejmani, sa i përket bashkëpunimit të Komitetit për Planifikim Strategjik, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit dhe drejtorisë përkatëse, tha se jeni të mirëseardhur në çdo kohë.

Ajo mes tjerash tha se e kemi edhe një Komision të formuar nga kryetari, që ka të bëjë me shqyrtimin e kushteve ndërtimore. Pra Komisioni i formuar për herë të parë, si dhe mundeni të marrë pjesë kohë pas kohe dikush nga ju, pasi që ka të bëjë me këtë komitet.

Sami Boroci propozoi të bëhet një projektplan, qysh kishim mundur me i parë disa pika të cilat na bashkojnë me drejtorinë përkatëse, si kishim mundur me shti si pjesë e planit të punës së Komitetit.

Mbledhja mbaroi në orën 16:30.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesi i Komitetit për PSUM
Amir Simnica



Faqe 2 nga 2